

# STATUT

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

### “Italian Coffee & Food”

Në bazë të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare e Biznesit” dhe të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, me vullnet të lirë, të shprehur në nënshkrimin e Aktit Themelues :

Z.Antonio Sadiku, i biri i Rolandit, lindur me, 08/08/1989, banues ne Tirane ,rr.Dibres, hyrja 1, AP 35, me ID: I90808061Q

Z.Renis Zaganjori, i biri i Xhezairit, lindur me, 23/03/1990, banues ne Tirane, rr.Ded Gjon Luli P.3/1, me ID: J00323065I

Vendosem te krijojme shoqërine me pergjegjesi te kufizuar sipa kushteve të mëposhtme:

## EMERTIMI, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI

### NENI 1

Shoqëria emërtohet “Italian Coffee & Food” sh.p.k.

### NENI 2

Selia e shoqërise tregtare private “Italian Coffee & Food” sh.p.k. do të jetë : Sheshi Italia, njesi biznesi kafeteri, Arena Center, Tirane .

Ajo mund te çelë dhe seli të tjera të dyta, degë e filiale, përfaqësi dhe agjenci operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe me miratim të organve kompetente edhe jashtë vendit.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, dege, të krijojë filiale si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendimin e ortakeve themelues të saj.

### NENI 3

Kohëzgjatja e shoqërisë është me afat të pacaktuar . Shoqëria e fiton personalitetin e vet nga moment i regjistrimit në Qendrën Kombëtare e Biznesit.

### NENI 4

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në fushën e:

1. Bar- kafe e restorant.

### KAPITALI I SHOQERISE

#### NENI 5

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare private "**Italian Coffee & Food**" sh.p.k. do të jetë **200.000** (dyqind mijë) lekë dhe do të përbëhet :

<b>Z.Antonio Sadiku</b>	<b>140.000</b>
<b>Z.Renis Zaganjori</b>	<b>60.000</b>

Perkatesisht

<b>Z.Antonio Sadiku</b>	<b>70%</b>
<b>Z.Renis Zaganjori</b>	<b>30%</b>

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë mund të ndryshohet, të shtohet apo të pakësohet (por jo nën vlerën e kapitalit themeltar fillestar ), sipas vendimit të ortakeve themelues të shoqërisë. Kapitali është tërësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm

#### NENI 6

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga kapitali themeltar fillestar, mjetet e xhiros, pasuri të luajtshme ose të paluajtshme etj, të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit të shoqërisë.

#### NENI 7

Kuota e kapitalit themeltar fillestar sigurohet nga ortaket themelues dhe eshte i regjistruar ne librin e llogarise te shoqerise.

#### NENI 8

Fitimet që realizohen gjatë veprimtarisë dhe që konkretizohen më nxjerrjen e bilanceve periodike, i takojnë ortakeve themelues, por kurdoherë pasi të jenë shlyer detyrimet ligjore.

#### NENI 9

Shoqëria tregtare "**Italian Coffee & Food**" sh.p.k. është përdoruese dhe disponuese e pasurisë së saj. Ajo mund të bleje dhe të shfrytëzoje të drejta të tjera, materiale dhe jo-materiale, duke përfshirë dhe të drejtën për shitjen e pasurisë së vet tek të tjerët.

Në Republikën e Shqipërisë, Shoqëria tregtare "**Italian Coffee & Food**" sh.p.k. gëzon të drejta, sikundër çdo person tjetër juridik, shqiptar ose i huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## NENI 10

Shoqëria tregtare "**Italian Coffee & Food**"sh.p.k. vepron ne regjimin e pronës private dhe merr përsipër të drejta e detyrime vetëm brenda kufirit të kapitalit të saj. Ortaket themelues të shoqërisë mbartin rrezikun e veprimtarisë së shoqërisë, vetëm në nivelin e kapitalit të investuar në të.

## DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

### NENI 11

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj, Z. Antonio Sadiku i cili është edhe përfaqësues ligjorë i saj. Afati i emërimit të administratorit është për një periudhë kohore prej 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

### NENI 12

Hyjnë brenda detyrave dhe kompetencave të ortakeve themelues si më poshte:

1. Nryshimi i aktit të themelimit dhe i statutit të shoqërisë.
2. Ndryshimi i selisë së shoqërisë dhe hapja e selive të reja.
3. Miratimi i buxhetit vjetor, i raporteve të administrimit, i inventareve dhe i bilancit e llogarisë vjetore.
4. Zgjedhja e administratorëve jo-ortakë dhe caktimi i detyrave dhe i kompetencave të tyre, me përjashtim të atyre që shënohen në statut.
5. Aprovimi i garancive që ka shoqëria.
6. Miratimi i tarifave për shërbimet që kryen shoqëria.
7. Pranimet në punë dhe largimet nga puna.
8. Caktimi i formës së vulës dalluese të shoqërisë.

### NENI 13

Administratori jo ortak përveç detyrave që i cakton ortaku themelues i shoqërisë ka edhe këto detyra e të drejta :

1. Të mirë-administrojë pasurinë e shoqërisë.
2. Të bëjë marreveshje me të tretet brenda objektit të veprimtarisë së shoqërisë dhe kompetencave të caktuara nga ortaku themelues.
3. Të zbatojë rregulloren e brendshme të shoqërisë.
4. Të përgjigjet për dëmet që i sjell Shoqërisë nga veprimet e tij.
5. Të paguhet për punën që kryen në bazë të marreveshjes të bërë me ortakun themelues.
6. Të marre të dhëna dhe të bëjë propozime për gjithçka që e çmon si të dobishme për shoqërinë.
7. Të kryejë të gjitha veprimet bankare që kanë të bëjnë me llogarinë e shoqërisë.

## TE DREJTAT DHE DETYRAT E SHOQERISE

### NENI 14

Shoqëria ka të drejtë :

1. Të kryej veprimtari në bazë të interesave që ka në përputhje me objektin e veprimtarisë.
2. Të sigurojë pasurinë e vet.
3. Të marrë kredi në lekë dhe në valutë nga bankat vendase dhe të huaja në bazë të rregullave ligjore.
4. Të përfitojë nga favoret që i njeh legjislacioni shqiptar lidhur me tatimet dhe të tjera.
5. Të investojë kudo në Shqipëri, nga të ardhurat që realizon gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj.
6. Të punësojë punonjës të thjeshtë ose të kualifikuar, vendas ose të huaj.
7. Të eksportojë lirisht valutën që ka realizuar nga fitimet e saj.

### NENI 15

Shoqëria ka për detyrë:

1. Të sigurojë kapitalin themeltar në formën dhe kohën e duhur.
2. Të japë garanci për shërbimet që kryen shoqëria.
3. Të sigurojë punonjësit e saj.
4. Të plotësojë detyrimet fiskale dhe sociale që ka ndaj shtetit, si edhe detyrimet kontraktuale ndaj cilitdo.
5. Të respektojë standartet si dhe të gjitha rregullat që lidhen me veprimtarinë e saj.

## MARREDHENIET EKONOMIKO-FINANCIARE TE SHOQERISE

### NENI 16

E gjithë veprimtaria e shoqërisë për plotësimin e objektit të veprimtarisë së saj, pasqyrohet në bilancin ekonomik të saj.

### NENI 17

Në selinë e shoqërisë mbahet dokumentacioni financiar, në bazë të të cilit, brenda datës 31 Mars të çdo viti nxirret bilanci.

### NENI 18



Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor.

#### NENI 19

Shoqëria mban xhiro-llogaritë në Bankë. Llogaritë mbahen në lekë dhe pasqyrohen në librat përkatëse.

#### NENI 20

Nga fitimet e realizuara gjatë vitit financiar, shoqëria, pasi bën zbritjet e humbjeve të vitit të mëparshëm, lë mënjanë 5 % të fitimit, me të cilin krijohet fondi "Rezervë e domosdoshme", deri sa ky fond të arrijë në masën 10 % të kapitalit themeltar.

#### NENI 21

Të ardhurat neto, pas veçimit të fondeve të përmendura më sipër dhe pagimit të detyrimeve fiskale, i mbesin në përdorim ortakut themelues të shoqërisë.

Konvertimi i parasë të realizuar nga shitja do të bëhet sipas kushteve që do të ketë Banka e Shtetit shqiptar, ose Bankat e tjera private dhe transferimi i saj do të bëhet në bazë të ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

### DISPOZITA TË VECANTA

#### NENI 22

Shoqëria ka vulën e vet dalluese.

### SHNDRRIMI, SHPERBERJA DHE PRISHJA E SHOQERISE

#### NENI 23

Shndërrimi i shoqërisë "**Italian Coffee & Food**" sh.p.k. në shoqëri aksionere, mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve (Ortaku i vetëm themelues).

Shoqëria mund të riorganizohet nëpërmjet bashkimit me një shoqëri tjetër, nëpërmjet ndarjes në dy apo më shumë shoqëri të tjera ose nëpërmjet shndërrimit të formës ligjore.

Shoqëritë mund të riorganizohen vetëm pasi kanë qënë të regjistruara për të paktën një vit. Bashkimi i shoqërive kryhet në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e konkurrencës.

#### NENI 24

Shpërbërja e shoqërisë, mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak, si:

- Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj.
- Me hapjen e procedurave të falimentimit.
- Pamundësi veprimi.
- Me vendim të asamblesë së ortakëve. ( Ortaku i vetëm themelues )

Administratori regjistron prishjen e Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit mbështetur në Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare e Biznesit” ,

Në këto raste, pronari i shoqërisë vendos mbi mënyrën e likuidimit dhe cakton një ose më shumë likuidatorë duke iu përcakuar edhe detyrat.

Likuidatori është përgjegjës për ruajtjen e pasurisë së shoqërisë përderisa ajo t’u dorëzohet personave përkatës fizik e juridik, duke likuiduar në radhë të parë detyrimet ndaj personave të tretë që ka shoqëria.

Në rast se fondet disponibël, rezultojnë të pamjaftueshme, për shlyerjen e detyrimeve të shoqërisë, likuidatori mund t’i kërkojë ortakut themelues të shoqërisë që të derdhë tërësisht kuotat që i takojnë atij.

### DISPOZITA TE PERGJITHSHME

#### NENI 25

Përsa nuk është shprehur plotësisht në këtë statut, referohen plotësimet që do të bëhen nga ortakët themelues, si edhe ligjeve të veçanta të legjislacionit shqiptar. Ndryshimet e plotësimet e këtij statuti bëhen me mënyrën dhe procedurën me të cilën nxirret vetë statuti.

#### NENI 26

Ky Statut përpilohet në dy kopje me vlerë të barabartë, nga të cilat njëra depozitohet në Qendrën Kombëtare e Biznesit, tjetra mbahet në dokumentat e shoqërisë tregtare “Italian Coffee & Food” sh.p.k.

### ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE

“Italian Coffee & Food” sh.p.k.

Antonio Sadiku

*Antonio Sadiku*  
*AS*

Renis Zaganjori

*Renis Zaganjori*

*Date 18. 11. 2013*

*[Signature]*